

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		27.06 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/04	30735	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas –Municipality of Drenas



P R O C E S V E R B A L

I

TUBIMIT TË PARË PUBLIK ME QYTETARËT PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2023

Drenas, 2023



RRETH NJOFTIMIT

Në mbështetje të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 7 pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores për Transparencë në Komuna, NR.03/2019, Kryetari i Komunës është i obliguar që të mbajë së paku dy takime publike me qytetarë. Tubimi i parë publik duhet të mbahet në gjashtë mujorin e parë kurse tubimi i dytë publik duhet të mbahet në gjashtë mujorin e dytë të vitit.

Andaj, bazuar në obligimet ligjore që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullorja për Transparencë në Komuna, Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Zyrën për Informim organizon Tubimin e parë publik për punën gjashtëmujore të vitit 2023.

Njoftimi për mbajtjen e tubimit publik, ashtu siç parashihet në Udhëzimin administrativ për standardet minimale të konsultimit publik, u publikua me: 7 qershor 2023, 14 ditë para mbajtjes së tubimit publik në ueb-faqen zyrtare të komunës së Drenasit, në Platformën qeveritare për konsultime publike si dhe në rrjetet sociale.

Linku në ueb-faqen e komunës:

<https://kk.rks-gov.net/gllgoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/06/Tubimi-i-pare-me-publikun-2023-pdf.pdf>

Linku në rrjetin social facebook:

<https://www.facebook.com/100057638043139/posts/pfbid0w5gp3ueNLBSrqJVBB7xBMRgy6RWPaan1UvJftHBYsgTMYMq5F6cw5usL5psdiBzcl/?mibextid=cr9u03>

Të gjithë administratorët e fshatrave dhe lagjeve, drejtorë të shkollave, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe përfaqësues të mediave, janë njoftuar me kohë.

Në këtë tubim publik, në koordinim me kryetarin e komunës kemi caktuar një rend dite, si vijon:

- PREZANTIMI I RAPORTIT GJASHTËMUJORËSH I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS
- INFORMIM RRETH PROJEKTEVE DHE AKTIVITETEVE NË KOMUNËN E DRENASIT
- PYETJE DHE PËRGJIGJE

Sipas nenit 10, pika 7 e Rregullores për Transparencë në Komuna, nëse parashtrohet ndonjë pyetje për të cilën nuk mund të jepet përgjigje menjëherë, parashtruesi ka të drejtë të kërkojë përgjigje me shkrim brenda 30 ditësh pas mbajtjes së tubimit.



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLLOGOC GLLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		07. 06 2023	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	066/01-27006		



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Në vështrim të nenit 68, Kreu i IX- Demokracia e Drejtpërdrejtë dhe Mekanizmat e Pjesëmarrjes së Qytetarëve, pika 68.1, 68.2 dhe 68.3 që ka të bëjë me informimin publik dhe konsultim të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 21, 22, 23, 24, 25 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe nenit 7 pika 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Komunale për Transparencë, Kryetari i Komunës së Drenasit:

ORGANIZON **Tubim me publikun**

Të mërkurën më datën **21.06.2023** duke filluar në orën **14:00**.

Tubimi me publikun do të mbahet në **Sallën e Kuvendit** dhe ftohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara të Komunës, të marrin pjesë në këtë Tubim Publik duke ju përmbajtur terminin të caktuar më lart.

Në këtë Tubim me publikun përfaqësuesit e Komunës do të informojnë pjesëmarrësit për aktivitetin e Komunës për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për të arriturat, vështirësitë dhe synimet, si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmujorin e parë dhe çështje tjera në interes të qytetarëve të Komunës.

Me respekt!



KRYETARI I KOMUNËS
Ramiz Lladrovci



P R O C E S V E R B A L

Vendi i takimit:	Data:	Ora:
Salla e Kuvendit, Komuna e Drenasit	E mërkurë, 21 qershor 2023	14:00

Takimi lidhur me Tubimin e parë publik me qytetarët për periudhën janar-qershor 2023, i kryesuar nga udhëheqësi i zyrës së informimit, Bekim Dobra, u mbajt më 21.06. 2023, në orën 14:00, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit. Në takim, përveç bartësve përgjegjës, në përbërje nga: Kryetari i Komunës, Zyra për Informim, Drejtorë të Drejtorive dhe njësitet tjera të komunës; qenë të pranishëm edhe: Përfaqësues të fshatrave, lagjeve si dhe lokaliteteve të ndryshme të komunës së Drenasit si dhe qytetarë të shumtë.

Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informimit, duke e hapur takimin i përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe ndër tjerash tha: I nderuari kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale, anëtar të Kuvendit të Komunës, administrator të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, organizatave jo qeveritare, ju qytetarë.



Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje

Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin gjatë gjashtëmujorit të parë, të vitit fiskal, pra ky që ne sot po e mbajmë, dhe tjetri në fundvit.

Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë njoftimin dhe ka publikuar dy javë para në web faqe të Komunës, në rrjetin social të Komunës, njoftimi është vendosur edhe në dy hyrjet e objektit të Komunës si dhe në mediat online.

Të nderuar të pranishëm,

Ndjej për obligim të ju njoftoj për rregullat e takimit!

Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës ju njoftojnë për aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti, për të arriturat dhe vështirësitë, për



synimet dhe investimet kapitale gjatë pjesës së dytë të këtij viti, ndërsa ju të pranishëm, mund të bëni pyetje dhe të jepni propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit dhe çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Për të elaboruar shkurtimisht aktivitetet e Komunës në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për sukseset dhe sfidat, ftoj kryetarin e Komunës, z. Ramiz Lladrovci.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës:

Të nderuar qytetarë të Drenasit,
Administratorë të vendbanimeve, Zonja e zotërinj,

Ju faleminderit që keni gjetur kohën të jeni sot pjesëmarrës në këtë tubim ku do të flas shkurtas për punën e gjashtëmujorit të parë të këtij viti.

Komuna e Drenasit me të gjitha mundësitë që ka në dispozicion, është duke punuar që t'i realizoj projektet e planifikuara sipas buxhetit të miratuar në Kuvendin Komunal.



Falënderoj qytetarët, të cilët na kanë mirëkuptuar e bashkëpunuar në arritjen e qëllimeve tona të përbashkëta. Falënderoj në veçanti administratorët e vendbanimeve që pa kursyer kohën e tyre, kanë bashkëpunuar me ekzekutivin për realizimin e projekteve për të mirën e përgjithshme.

Komuna jonë për vitin 2021, rezultat që e kemi të konfirmuar sivjet, është komuna e parë në nivel vendi me performancën më të mirë dhe kemi fituar grantin mbi 2 milion e 34 mijë euro. Këto mjetet do të shfrytëzohen në realizimin e projekteve për të mirën e komunitetit.

Të nderuar të pranishëm,

Gjatë kësaj periudhe sa po raportojmë, janë në realizim dhjetëra projekte në infrastrukturë, arsim, shëndetësi e fushat tjera duke ngritur cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët.

Po vazhdon asfaltimi i rrugëve, rregullimi i rrjetit të kanalizimit në shumicën e vendbanimeve dhe synim vetës i kemi dhënë që shumë shpejtë këtë problem të zgjidhim në secilin vendbanim, duke finalizuar edhe ndërtimin e kolektorëve për të trajtuar të gjitha ujërat e zeza.



Së shpejti, shpresoj se çështja e ndriçimit publik po finalizohet, duke u kryer në të gjitha lagjet e fshatrat e komunës tonë.

I kemi kryer detyrat tona lidhur me QKMF-në e re dhe presim fillimin e procedurave për ndërtimin e saj, po vazhdon Renovimi i QMF-ve e AMF-ve.

Projekti i BE-së për arsim, Projekti për avancimin e përsheptuar të cilësisë në arsim, Renovimi i objekteve shkollore, rrethojat e fushave sportive, instalimi i energjisë eficiente, kabinetet e informatikës në të gjitha shkollat me laboratorë e mjete konkretizimi, janë disa nga aktivitetet për arsim në komunën tonë.

Po bëjmë renovimin e objekteve sportive, dhe po vazhdojmë me ndërtimin e Stadiumit “Rexhep Rexhepi” dhe palestrës “Hysni Jetullahu”, po ndërtojmë fusha sportive në fshatra si dhe po bëjmë furnizimet e duhura ee përkrahjen e ekipeve tona sportive. Në mesin e këtyre rezultateve është hyrja e “F.C. Feronikli ‘74” në Super ligën e Kosovës.

Drejtoritë si ajo e Buxhetit dhe Financave, Ambientit dhe rregullimit hapësinor, Administratës dhe Inspektorati, janë në nivel të detyrës, duke përmbushur programin e vet të punës secila drejtori, me performancë të shkëlqyer.

Duhet lavdëruar mbledhjen e borxheve dhe vjeljen e taksave, ku përqindja e realizimit të planit është rreth 200% nga plani.

Drejtoria e zhvillimit ekonomik ka sukseset e lidhura me bizneset, regjistrimin e tyre si dhe angazhimin për Qendrën e biznesit “Drenasi 2”.

Shërbimet publike veprojnë 24 orë në shërbim të qytetarëve, nga kujdesi për deponitë, luftimin e deponive të egra, intervenimet emergjente, ndriçimi publik, rehabilitimi i rrugëve, mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimeve është në nivelin e duhur, me investime të konsiderueshme.

Po vazhdojmë bashkëpunimin me organizatat që financojnë hapjen e puseve, përkrahjen e fermerëve përmes subvencionimit me pajisje të nevojshme për t’ua lehtësuar veprimtarinë. Sivjet është numri rekord i aplikimeve për subvencione, 1.163 aplikantë. Po ashtu, vëmendje i kemi kushtuar pyjeve, ku do të bëhet regjistrimi i tri objekteve pyjore dhe aktivitete tjera nga kjo lëmë.



Për ambientin jemi kujdesur duke mbjellë fidanë në qytet, jemi duke zbatuar Planin Zhvillimor Komunal dhe hartat zonale.

Në shëndetësi kemi rekrutuar personelin e lejuar me ligj, kemi shtuar furnizimet me material shpenzues e sanitar, jemi furnizuar me material për stomatologji dhe filma të rëntgenit.

Jemi kujdesur për rrethojat e QMF-ve dhe AMF-ve, ngrohjen, pjerrinat si dhe kemi blerë një autoambulancë si dhe kemi kontratë për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve.

Infrastruktura lokale përbën punët kapitale të angazhimit tonë, gjithandej po ndërtohen dhe janë në proces të ndërtimit.

Së shpejti fillon Rindërtimi i Sheshit “Fehmi Lladrovci”, Presim ta finalizojmë rrjetin e kolektorëve të ujërave të zeza, urat dhe tombinat në shumë lagje të komunës tonë.

Në Drenas po bëhet rikonstruktimi dhe zgjerimi i rrugëve, asfaltimi në dhjetëra lokalitete dhe shtruarja me zhavorr i shumë rrugicave gjithandej komunës tonë.

Është finalizuar parkingu për mbi 360 makina, kanale kulluese, shtrati i lumit, si dhe jemi në proces të ndërtimit të parkut dhe shtigjeve për këmbësor në pishat e Kamenicës.

Për ujin e pijes kemi intensifikuar kërkimin e llogarisë nga KRU Prishtina, që të aftësohen sa më shpejtë pajisjet e domosdoshme për ujin e pijes për 22 fshatra. Në të kundërtën, kemi paralajmëruar padi, për diskriminim të qytetarëve të 22 fshatrave.

Rrejt i kanalizimit po finalizohet duke përfshirë të gjitha lagjet e fshatrat e komunës, do të bëjmë kubëzimin dhe rehabilitimin e rrugëve.

Do ta rregullojmë tregun dhe për herë të parë do të përfshijmë edhe aftësimin e rrugëve fushore për fshatrat tona. Vëmendja jonë për fshatin do të jetë e vazhdueshme.

Ka filluar ndërtimi i rrugës Llapushnik-Berishë, Rruga për Çyçavicë dhe presim të finalizohet rruga qarkore Kroni i Mbretit – Drenas.

Investitorët si asnjë herë më parë janë të pranishëm në komunën tonë, të interesuar për fusha të ndryshme si energjia e ripërtëritshme, dy ofertues shumë serioz, një ofertues për Liqenin e Vërbocit, ofertues për prodhuesin më të madh në botë për mishin e pulës, e kompani të tjera.

Gjeodezia, prona e Kadastra, është e angazhuar maksimalisht për ta futur në sistem tërë tokën komasative, sepse pa këtë proces, qytetarët nuk mund të marrin fleta poseduese, që nga viti 1984/1987, sepse, nuk dihen kufijtë e saktë të pronave të qytetarëve. Kjo brengë na ka përcjell për 30 e 40 vjet.

Jemi të përkushtuar që ta aftësojmë Parkun e Biznesit, Drenasi 2 dhe jemi të lumtur se gjithçka do të ecë më shpejtë e më mirë se deri sot.

Të nderuar të pranishëm,

Duke marr edhe propozimet tuaja të dala nga dëgjimet buxhetore, ne kemi arritur t'i realizojmë thuajse të gjitha projektet e planifikuara, duke i shtuar ato dhe duke tejkaluar planin.

Ju ftoj që edhe në gjashtëmujorin e mbetur të këtij viti dhe viteve në vazhdim të bashkëpunojmë për të mirën e qytetarëve, duke e lehtësuar jetën e qytetarëve me projekte cilësore në shërbim të kualitetit të jetës tonë.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informim: Të nderuar të pranishëm tani fjala është për ju, por paraprakisht lus që kur ta merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit të takimit si dhe mbajtjes së procesit për t'i adresuar kërkesat, apo sugjerimet tuaja.

Fjalën e mori **Samedin Kiçina, administrator nga fshati Baicë**, ku tha: Kërkoj të punohet në rrugën Sabit Leku, rr. Zeqir Kiçina dhe Vëllezërit Elshani, të ketë trotuare dhe ndriçim. Dy shtëpi ne lagjen Elshani dhe Zariqi kanë mbetur pa kyçje në kanalizim, si dhe ta kemi një fushë sporti. Dhe një kërkesë të fundit, këtë herë në emër të të gjithë administratoreve që ishin aktiv gjatë kohës së pandemisë. Kërkojmë që të paktën ta kemi nga një mirënjohje nga komuna, për kontributin e dhënë.



Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Lus që kur ti parashtroni kërkesat neper drejtori, t'i bëni ato ne qershor dhe gusht.

Sa i përket rr. Sabit Leku, kemi hasur në një problem, pasi që rruga sipas skicës që posedojmë ne si komune, figuron nëpër vija tjera. Ndriçim jemi duke bërë për 4 km. Fushë sportive, ju si fshat e keni, madje shumë cilësore.

Me duhet ta pranoj se keni të drejtë për mirënjohjet dhe ne do të marrim hapin e duhur për dhurimin e këtyre mirënjohjeve.

Nasuf Mulaku, administrator i Komoranit 3: Përshëndetje të gjithëve, desha te informohem ne lidhje me asfaltimin e rrugës së lagjes Obria, deri ku kanë shkuar procedurat, si dhe kanalizimin. Po ashtu, do të dëshiroja të kemi një fushë sportive, si dhe rrethoja e varrezave ende nuk është bërë.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Në dy kërkesat e para, nuk është lidhur ende kontrata. Sa i përket rrethojave të varrezave, ende nuk është cilësuar ai vend për vend-varreza.

Hajrush Musliu, administrator i fshatit Shtrubullova: Përshëndetje për të gjithë, në fshatin Shtrubullova, është punuar shumë dhe për këtë jam falënderuar. Tre rrugë janë përgatitur për asfaltim, por ende nuk është kryer asfaltimi.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Hajrush, jemi duke pritur deri në fund të muajit përgjigje nga kompania kontraktuese. Dhe nëse nuk kemi ndonjë përgjigje nga kompania atëherë do të ndërmarrim hapat e mëtejshëm.

Habib Gashi, administrator i fshatit Nekovc: Përshëndetje, unë desha të të them se 80% lagja Dugolli dhe Rrukiqi nuk kanë kanalizim. Lumi mundësisht të pastrohet. Çerdhe në fshat nuk ka, si dhe fushë sporti po ashtu.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: I nderuar, kanalizimi në lagjen Lugu, Rrukiqi dhe Dugolli, do të shtrohet. Kanali i Ibër-Lepencit është kompetencë e Ibër-Lepencit. Sa i përket çerdhes, i nderuar nuk ka shanse të ndërtohet, pasi që nuk po na lejohet të rekrutojmë staf (edukatorë/e) të ri.

Zekë Kluna, administrator i fshatit Poklek i Vjetër: Përshëndetje të gjithëve, unë kërkoj që të behet asfaltimi i rrugës tek lagja Cervadiku. Gropa septike e cila ndodhet mbi ujin e thartë të hiqet



si dhe puna e vigut për këmbësorë, të kihet parasysh pasi që është në nevojë të banorëve të fshatit tonë.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Zekë, nuk ka më gropë septike mbi ujin e thartë, d.m.th ai problem është sanuar. Sa i përket vigut për këmbësorë, nuk mundemi të bëjmë ende asgjë pasi që problemi qëndron tek pronat private. Pra, pa aprovimin e pronarëve aktual të pronave, nuk mund të bëhet diçka. Ju, siguroni pëlqimin e pronarëve të tokave andej dhe ne do të ndërmarrim hapat e duhur. Rruga në lagjen Cervadiku, vet banorët e asaj lagje kanë kërkuar që të shtyhet asfaltimi për pak kohë.

Xhevdet Demaku, administrator i fshatit Abri e Epërme: Përshëndetje të gjithëve, desha të kërkoj të bëhet asfaltimi i disa rrugicave, si lagja Hajdari, po ashtu të kemi kanalizim. Fusha e sportit ka nevojë për vijëzim. Në shkollën Shotë Galica, është duke u punuar renovimi dhe mundësisht të bëhet edhe instalimi i ri i kabllave elektrike, pasi që instalimi është i vjetruar. Dhe për fund kërkoj të bëhet ndihmesë bujqve të cilët kanë pësuar dëmtime në të mbjellat e tyre. Ju e dini që kemi bujq shumë të suksesshëm, siç është rasti me ndërmarrësin e suksesshëm vëllezërit Hajdari.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: I nderuar, sa i përket rrugëve, nuk mund të bëjmë edhe kush e di sa, pasi që ato janë rrugë private. Kanalizimi sigurisht se është thuaja shtruar në fshat, ndërsa pusetat sigurisht se duhet mirëmbajtur. Edhe vijëzimi i fushës sportive sigurisht se do të bëhet, pasi që nuk është kush e di çka. Në lidhje me instalimin e ri të shkollës, mundësisht të na i tregoni parametrat me kohë në mënyrë që t'i fusim në paramasa mandej. Sa i përket dëmtimeve në bujqësi, sigurisht se ndihmohen, vetëm se duhet të aplikojnë në sektorin e bujqësisë.

Bajram Qallapeku, administratori i fshatit Tërstenik 1 dhe 2: Përgëzoj kryetarin Lladrovci, por edhe komunën e Drenasit për punën dhe përkushtimin që po tregojnë ndaj qytetarit, dhe uroj që edhe në të ardhmen të vazhdohet kështu. Kërkoj që të kemi ujësjellës, pasi që edhe ju e dini se nuk kemi, të bëhet asfaltimi i rrugës dhe trotuari tek përmendorja në lagjen Bazaj. Tek lagja Cakiqi, na duhet një kanalizim pasi që po grumbullohet uji në atë vend.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Bajram, ngado që ka rrejt, do të ketë edhe ujësjellës. Rrugët dhe kanalizimi janë në proces e sipër.



Kadri Ajazi, administrator i fshatit Sankoc: Përsëritet për të gjithë, në fshatin Sankoc, është punuar dhe po punohet, dhe për këtë ju përgëzoj si komunë. Kemi ende rrugica nëpër fshat që duhet e asfaltohen, kanalizim si dhe trotuare nuk kemi në fshat ende. Ndriçimi të bëhet aty ku ka shtylla të betonit. Të bëhet shtrimi i rrugës Zabel-Sankoc. Një fermer ka kërkuar t'i lirohet një lokacion, ku ka synim ta rris afarizmin e tij.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Kadri, rrugën e kam premtuar dhe do ta bëjmë. Trotuaret do të asfaltohen aty ku ka hapësira publike. Ndriçimi është duke u kryer diku 95% për këtë në tërë territorin e komunës. Sa i përket fermerit, ju e dini që nuk ka të drejtë të investoj në pronë të shtetit.

Arben Haziri, administrator për fshatrat Krajkovë dhe Damanek: Nëse është e mundur ta kemi ujësjellësin pasi që shumë banorë edhe e kanë lëshuar vendin nga Krajkova si pasojë e mungesës së ujit.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: I nderuar, sa i përket ujit, komuna e ka kryer punën e vet. Është KRU Prishtina ajo e cila nuk po i kryen punët e saj dhe për këtë ne si komune do të ndërmarrim hapat e nevojshëm.

Skënder Bogiqi, administrator i Komoranit 3: Rrugët Azem Bogiqi dhe rruga Binaku të shtrohen pasi që janë në prone publike. Ujësjellës nuk kemi edhe pse kemi gypat tashmë të shtrirë.


Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Rrugët do të shtrohen, dhe lus që jo vetëm ti por i lus të gjithë që keni probleme me ujësjellës, të ma dërgoni nga një mesazh, pasi që muajin tjetër do ta kemi drejtorin e KRU Prishtina në mbledhje të kuvendit ku edhe do të raportoj.

Qerim Bërbatovci, administrator i fshatit Godanc: Përsëritet për të gjithë. Mundësisht të bëhet ndriçimi në lagjet e fshatit si dhe ta kemi një fushë sporti.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Qerim, ndriçimin do ta bëjmë, për fushën e sportit, ju e dini se jemi munduar ta bëjmë dhe prapë do të mundohemi, pavarësisht hapësirës.




Metodat e konsultimit	Data /Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i komenteve, kërkesave, sugjerimeve	Numri i kërkesave të pranuara
Takimi i drejtpërdrejtë me të gjithë qytetarët e komunës së Drenasit të organizuar nga Kryetari i Komunës, për raportim për periudhën janar-qershor 2023	21.06.2023 14:00-15:20	45	11	11



















Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informimit: Atëherë, nëse dikush tjetër nuk ka për të shtuar diçka, apo ndonjë kërkesë, duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, ky takim përfundoni tani.

Me kaq takimi mori fund në orën 15:20.

Shënim:

*Në lidhje me tubimin e parë me publikun, nuk është pranuar asnjë komentim, sugjerim apo vërejte përmes postës elektronike, në emailin e komuna.drenas@rks-gov.net dhe bekim.dobra@rks-gov.net

Dokumentet e bashkëngjitura:

Ftesa për pjesëmarrje; si dhe,

Lista e pjesëmarrësve.

Procesmbajtësi

Arton Hasani

Zyrtar për Informim dhe Monitorim të Mediave



LISTA E PJESËMARRËSVE NË TUBIMIN ME PUBLIKUN PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2023 –
21.06.2023

Nr	Emri dhe mbiemri	Fshati/vendbanimi	Nr. telefonit	Nënshkrimi
1	HAJRUSH MUSLIU	SHTRUBULL	044256829	<i>Hand</i>
2	IMR BASHIRI	KISHINDE	044-201296	<i>Bashir</i>
3	ARBON ISTOGU	POLLICZH	044-207-372	<i>Arb</i>
4	SKAIDE BAGA	KOLLOJ-IV	044-181034	<i>Skaida</i>
5	NOJFY DEULE	KOMORU III	044834149	<i>Nojfy</i>
6	HULIT ÇETI	FAM VII	048181672	<i>Hulit</i>
7	KAMRUE	KARAJIA	044895091	<i>Kamrue</i>
8	ADRIANE ÇETI	DRENAS	044/741-088	<i>Adriane</i>
9	SHKUR BASHIRI	DRENAS	043670337	<i>Shkur</i>
10	SHKUR BASHIRI	DRENAS	0431878-834	<i>Shkur</i>
11	BEGIM BASHIRI	TEPSTEN	0491405/438	<i>Begim</i>
12	SEMEDIN KICINA	BATIC	044842361	<i>Skurino</i>
13	KADRI AJAZI	SANKOC	044.613-077	<i>Kadri</i>
14	HATEM AJAZI	SANKOC	045892908	<i>Hatem</i>
15	ENVER HOXHE	KOMORU	044-181-176	<i>Enver</i>
16	FAHREDIN HAJDINI		048314881	<i>Fahredin</i>
17	CHRIST BACA	KOMORU	044321067	<i>Christ</i>
18	NDRIÇIM BUJUPI	ARLIAT	049/608-354	<i>Ndriçim</i>
19	SHABAN PERISAN		049 816.303	<i>Shaban</i>
20	GERIUM BERB.	GODACE	044-174-302	<i>Gerium</i>
21	FITIM GASHI	LAPUSHNIK	044/3031902	<i>Fitim</i>
22	HABIB GASHI	NEKOVC	044 197 130	<i>Habib</i>
23	ARBEN HAZIN	KRAKOVE	049-164-119	<i>Arben</i>

24	Xhevole Demak	Abri e Epërme	044367019	10/1/2019
25	Fitor Tahiri	Likoshan	045346647	10/1/2019
26	Kosovane Kanaka	Gilestari	049-755-977	10/1/2019
27	Zekë Klina	Pokleki	044-296-399	10/1/2019
28	Djaba Basha	Llapushnik	049-678-317	10/1/2019
29	LIRIDONË MIZAKU	KOMORAN	049-978-882	10/1/2019
30	Elkencin	Tranca	044-888-151	10/1/2019
31	Leonora Shala	VUGAK	049-623-096	10/1/2019
32	ARTON HASANI	SHTRUBUHA	048-564-215	10/1/2019
33	Shyqiri Basha	Zabeli i ulët	049-978-373	10/1/2019
34	Haxhmedin Goruda	Komoran	049-929-717	10/1/2019
35	PETRIZ GASHI	LAPUSHNIK	044-500-620	10/1/2019
36	Enkele Dena	Drenas	049-977-897	10/1/2019
37	FLUTURA AVAN	Zabeli i ulët	049 978 021	10/1/2019
38	Laudeta Thaci	Llapushnik	049-642-992	10/1/2019
39	Arinda Abdullahu	Drenas	049/978-777	10/1/2019
40	Vlora Gjinafi	Drenas	049/929/900	10/1/2019
41	Gjanturje Gjini	Drenas	049 977 802	10/1/2019
42	Muhamet Gjoka	Tërstenile	049 80 0029	10/1/2019
43	ENDER GJOKA	VUGAK	049 258 313	10/1/2019
44	Bakim Dobro	Drenas	049 917 799	10/1/2019
45	Arben Shala	Vugak	049 164 522	10/1/2019

46.

